# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-446601**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “17 vite në gjykata, por pronën ende po na e rrethojnë”/ Denoncimi nga Fushë Mbret në Elbasan |
| ADRESA | https://joq-albania.com/artikull/1391838.html |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 15:45:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 15:37:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 15:36:00 UTC → 15 shtator 2026, 15:38:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | d2d258427b0e28f1fe8631839554b7b91c7d4ed8dd4cf4c0e75f8b7181748825 |
| TEKSTI | e473b7c4f151f683c8ee1ab38e989b6feb0e50fba91fe3584c9b90ac94201f8f |
| PAMJA | 237b672c3d69ef79f98ef72acd591cd7a3a44e680c004ef5ee84c8492bded8cb |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | a281c0c8148cbd9057077ab02b0d45064780e8f64c1a515ac48580c4859cc00a |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 732ea03e09e76f3f4c4f7148212f99ed57cacfcbea6b7c5016ac103a159e81ab |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a281c0c8148cbd9057077ab02b0d45064780e8f64c1a515ac48580c4859cc00a

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# “17 vite në gjykata, por pronën ende po na e rrethojnë”/ Denoncimi nga Fushë Mbret në Elbasan

Shkruar nga: Y Pepa | Publikuar më: 15.09.2026, 17:37

Share Share



Një qytetar i është drejtuar redaksisë së JOQ Albania për të denoncuar një konflikt pronësie në Fushë Mbret, lagjja “Skënderbej”, Elbasan, pranë ish-Kombinatit të Drurit.

Sipas denoncuesit, familja e tij pretendon se është pronare e tokës, ndërsa prej rreth 17 vitesh është përfshirë në procese gjyqësore për pronën.

Qytetari thotë se, pavarësisht se familja ka përfituar edhe dëmshpërblim nga shteti, prona sipas tij nuk është liruar dhe personat e tjerë vijojnë ta përdorin.

Në pamjet e dërguara në redaksi shihet një sipërfaqe toke e rrethuar me rrjetë metalike, e vendosur mbi shtylla druri. Rrethimi përfshin edhe një pemë, ndërsa brenda hapësirës duken gjurmë automjetesh dhe tokë e pastruar.

Denoncuesi shprehet i shqetësuar se rrethimi po vijon ndërsa institucionet, sipas tij, nuk kanë ndërhyrë për zgjidhjen e situatës.

“Kam një problem me tokën. Ne jemi pronarë, edhe problemi është se e kanë zaptuar të tjerët dhe po e rrethojnë. Edhe institucionet nuk funksionojnë. Dua që të bëhet publike, sepse kanë gati 17 vite nëpër gjyqe. Kemi marrë dëmshpërblim nga shteti, por prona nuk është liruar ende dhe tani po e rrethojnë. Nuk di si të veproj në këtë situatë.”

Familja kërkon që institucionet përgjegjëse të verifikojnë dokumentacionin e pronës, vendimet gjyqësore dhe statusin e saj, si dhe të sqarojnë se kush ka të drejtë ta përdorë dhe rrethojë këtë sipërfaqe.

Pretendimet për zaptim dhe moszbatim të vendimeve kërkojnë verifikim përmes dokumentacionit zyrtar dhe nuk mund të konsiderohen si fakte të provuara vetëm mbi bazën e denoncimit.

JOQ Albania publikon pamjet dhe shqetësimin e familjes, ndërsa pret një reagim nga institucionet përgjegjëse dhe personat që pretendohet se kanë zënë pronën.



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?



View this post on Instagram

A post shared by JOQ News (@joqnews)

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

## Më të fundit

Dërgo materialin tënd këtu ›

Puno me ne! Marketing Politika e privatësisë Rreth Nesh Kushtet e përdorimit Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.